



Pranimi / Doretimi Prilaz / Prilaz Received / Delivery	07-11-2023	3	vit god year
Organ / Shkëmbim Org / Unit	In Prot Pr Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Kopje Kopje Quantity
SKOPJSHCK	6912	2023	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1192/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1192/2023 të datës 21.09.2023 të ankueses e përfaqësuar nga me adresë:

kundër Vendimit KA.nr.29/2023 të datës 01.09.2023 të komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.11.2023, mori:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.29/2023 i datës 01.09.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Njoftimi për për zgjedhjen përfundimtare me Nr:03/1048 i datës 19.07.2023, Lista e ngushtë e kandidatëve duke përfshirë rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe Propozimi për emërim i datës 19.07.2023 i Komisionit Përzgjedhës, anulohen, dhe lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* të Komisioni Përzgjedhës.

II. Obligohet Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të *ri-zhvilloj* procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve" në Gjykatën Komerciale, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja e cila sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve" në Gjykatën Komerciale të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje referuar SKGJK), me datë 21.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) e cila është regjistruar dhe protokolluar me numër 6183/2023, kundër Vendimit KA.nr.29/2023 të datës 01.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me rastin e refuzimit të ankesës së ankueses, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material dhe deri tek nxjerrja e Vendimit KA.nr.29/2023 të datës 01.09.2023 ka ardhur për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me kërkesën që Këshilli të anuloi Vendimin KA.nr.29/2023 të datës 01.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Njoftimin e datës 19.07.2023 për shpalljen e kandidatit të suksesshëm.

Këshilli bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 27.09.2023 dhe datë 24.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të SKGJK, ndërsa me datë 02.10.2023, 31.10.2023 dhe 01.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.09.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-maili i datës 21.09.2023 dërguar nga ankuesja në Këshill; Vendimin KA.nr.29/2023 të datës 01.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Autorizimin e datës 24.07.2023; E-mailin e datës 25.09.2023 me korrespondencën e bashkangjitur për plotësimin e ankesës; Zarfin postar me shifër R5545680; Njoftimin e datës 19.07.2023; Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Formulari për përcaktimin e kriterëve për testin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim dhe udhëzuesin për ankuesen i datës 11.07.2023; Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për ankuesen; Kërkesën e ankueses për qasje në dokumente publike drejtuar SKGJK-së; Testin me shkrim dhe udhëzuesin për kandidatit i datës 11.07.2023; Aktin e emërimit për kandidatit i datës 03.09.2018; Vendimin e datës 28.06.2022 të Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Çertifikatën e datës 04.01.2017 lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore Gjakovë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.10.2023; Përgjigjen e datës 31.10.2023 dhe 01.11.2023; Konkursin e datës 02.03.2023; Aplikacionin e datës 09.03.2023 të kandidatit i datës 09.03.2023. Diplomën e datës 28.2016 me shifër Nr.3841; Çertifikatën e lindjes të datës 17.08.2022 (viti jo i qartë për identifikim); Ekstraktin e regjistrit të gjendjes civili i datës 10.03.2023; Çertifikatën e shtetësisë e datës 10.03.2023; Pasqyrën e llogarisë së trustit e datës 27.01.2022; Njoftimi për kandidatit e suksesshëm i datës 20.07.2023; Propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 19.07.2023; Formulari i renditjes përfundimtare i datës 14.07.2023; Formulari i përmbledhjes së vlerësimeve individuale i datës 14.07.2023; Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidatit i datës 14.07.2023; Deklarata e datës 16.06.2023; Formularin e renditjes përfundimtare i datës 14.07.2023; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale e datës 14.07.2023; Testi me shkrim i kandidatit të suksesshëm; Çertifikatë e lindjes e datës 17.08.2023; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civili i datës 10.03.2023; Çertifikatë e shtetësisë e datës 10.03.2023; vendimin e datës 28.06.2023; Pasqyrë e llogarisë-Trust e datës 27.01.2022; Akt emërim i datës 03.09.2018; Çertifikatë e datës 04.01.2017; Formulari i aplikacionit të punësimit i kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur; Formulari i aplikacionit të punësimit i kandidatës me

dokumentacionin e bashkangjitur; Përgjigjen e datës 12.10.2023; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të ankesave të datës 01.09.2023; Vendimin e datës 06.06.2023; Formulari i aplikacionit të punësimit i ankueses me dokumentacionin e bashkangjitur i datës 09.03.2023; Çertifikatë e datës 22.12.2016; Pasqyrë e llogarisë Trust.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që lënda të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, gjegjësisht Komisioni i Pranimit, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se SKGJK duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.03.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për pozitën "*Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve*" në Gjykatën Komerciale, ndërsa bazuar në Renditjen Përfundimtare të kandidatëve konstatohet fakti se ankuesja ka arritur ti mbledh 346.25 pikë duke u renditur e dyta në listë, rrjedhimisht nuk është përzgjedhur si kandidate fituese, ndërsa sipas njoftimit të datës 19.07.2023 rezulton se kandidati i suksesshëm është _____ i cili njëherit edhe është propozuar për emërim pasi që kishte arritur gjithsejtë 381 pikë.

Ankuesja, e pakënaqur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, kishte parashtruar ankesë të brendshme me pretendimin ankimor se kandidati i përzgjedhur nuk ka ofruara dokumentacionin përkatës me rastin e aplikimit sikurse është kërkuar në konkurs, si dhe me pretendimin për shkelje të tjera procedurale të përcaktuara me rregulloren në fuqi për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, ndërsa Komisioni për Zgjedhjen e kontesteve dhe Ankesave në SKGJK përmes Vendimit me numër KA.nr.20/2023 të datës 23.06.2023 kishte refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses me arsyetimin se në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati fitues i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara me konkurs. Në këtë mënyrë Menaxheri i Personelit ka nxjerr Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën e shpallur të konkursit nga rezulton se ankuesja nuk ishte kandidate e përzgjedhur.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses dhe rrjedhimisht vlerësimin e ligjshmërisë se procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse, Kolegji i Këshillit, ju referua Konkursit me numër 01/2023 të shpallur me datës 02.03.2023 për pozitën "*Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve*" në Gjykatën Komerciale, dhe si rrjedhojë konstatoi se kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë Universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik.*
- *Përvoja e punës: Se paku pesë (5) vite përvoja pune.*

Po ashtu, në konkursin e datës 02.03.2023 të shpallur për pozitën "*Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve*" përveçse është përcaktuar afati i aplikimit i cili ka zgjatë nga data 02.03.2023 deri me datë 09.03.2023, në të njëjtin është kërkuar që: "*Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm; Aplikacionit duhet bashkangjitur kopjen e kualifikimeve arsimore të kërkuara sipas konkursit; Aplikacionit duhet bashkangjitur kopjen e Akt/emërimit/kontratës së punës; Aplikacionit duhet bashkangjitur kopjen e vlerësimit të performancës për 2 (dy) viteve të fundit; Çertifikatën mbi dënimet penale dhe Kopjen e letërnjoftimit*", me përmbajtje se: "*Vërejte-nëse aplikacionit nuk ia keni bashkangjitur dokumentet e kërkuara më lartë dhe nuk e plotësoni at me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë*".

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesën e datës 21.09.2023 lidhur me anulimin e Vendimit KA.nr.29/2023 të datës 01.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Njoftimit të datës 19.07.2023 për shpalljen e kandidatit të suksesshëm, Këshilli me datë 27.09.2023 e kishte njoftuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SKGJK-së se ka pranuar ankesën e ankueses me datë 21.09.2023 duke i njoftuar me përmbajtjen e saj, dhe përveç tjerash kishte kërkuar aplikacionet e kandidatëve në procedurë me dokumentacionin e bashkangjitur të cilët kanë hyrë në listën e ngushtë, po ashtu për shkak të provave të mangëta të cilat ishin pranuar përmes shkresës së datës 12.10.2023 me shifër SKPMSHCK-1192/2023, Këshilli sërish i është drejtuar përmes e-mailit të datës 24.10.2021 Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SKGJK-së, me kërkesën për plotësim të provave, ku ndër të tjera citoj shkresën: "... kërkojmë që të ofroni konkursin për pozitën specifike e cila kontestohet në këtë procedurë, (pasi që kopja e konkursit të sjellë nuk ishte për këtë pozitë) si dhe komplet dosjen E kandidatit të suksesshëm dhe kandidatëve të tjerë që kanë hyrë në listën e ngushtë."

Nga analizimi shkresave të lëndës të pranuar përmes përgjigjes së datës 12.10.2023 dhe asaj të datës 31.10.2023 përmes e-mailit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SKGJK-së, Kolegji i Këshillit sipas shkresave të ofruara dhe aplikacionit të kandidatit të përzgjedhur, ka konstatuar se në aplikacionin e datës 09.03.2023 të kandidatit të përzgjedhur nuk janë bashkangjitur edhe dokumentet e kërkuara sipas konkursit të datës 02.03.2023, respektivisht nuk janë gjendur të bashkangjitura kopja e vlerësimit të performancës për 2 (dy) viteve të fundit dhe Çertifikata mbi dënimet penale të cila njëherit përveçse që kanë qenë dokumente të kërkuara me rastin e aplikimit, janë edhe kritere përmes të cilave konstatohet fakti nëse kandidatët në procedurë i plotësojnë kushtet për avancim sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.7 të Rregullores 21/2012 për Avancimin në Karrierë në Shërbimin Civil, ngase kandidati në procedurë, respektivisht kandidati i përzgjedhur sipas Vendimit të datës 28.06.2022 nga pozita Zyrtar Ligjor në Gjykatën e Apelit është transferuar në pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Komerciale, andaj pozita që mban ankuesi "Zyrtar Ligjor" është pozitë më e ulët sesa pozita në të cilin ka rezultuar kandidat i suksesshëm sipas njoftimit të datës 19.07.2023, prandaj në secilën situatë kur nëpunësi civil kur aplikon në një pozitë më të lartë sesa pozita që mban duhet të dëshmojë përmes aplikimit se i njëjti i plotëson dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimet e dhëna si më lartë, konstaton faktin se me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përmes të cilës kandidati i përzgjedhur është përfshirë në listën e ngushtë pavarësisht se nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e kërkuara sikurse janë kopjen e vlerësimit të performancës për 2 (dy) viteve të fundit dhe Çertifikatën mbi dënimet penale, Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 paragrafi 2 të Rregullore Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ngase mos plotësimi i aplikacioneve sipas kërkesave të konkurset përbën shkak për refuzimin e aplikacionit në fazën e shqyrtimit të tij.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Përzgjedhës në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e përgatitjes së listës së shkurtër përmes të cilës kandidati i përzgjedhur është përfshirë në listën e ngushtë, nuk ka arritur të dëshmojë apo arsyetojë në mënyrë plotë dhe të drejtë nëse të gjithë kandidatët në procedurë i kanë plotësuar aplikacionet e tyre me kërkesat e dhëna sikurse në konkursin e shpallur të datës 02.03.2023, ashtu që i njëjti komision ka vepruar në kundërshtim me 24 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 dhe 2.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve ushtrohet nga KPSHC, kompetente dhe përbehet nga: 2.1 shqyrtimi i aplikacioneve të dorëzuara përmes vlerësimit dhe 2.2

përpilimi listës së shkurt të kandidatëve për testim”, prandaj secili veprim i ndërmarrë procedural pas kësaj faze, duke përfshirë kandidatin e përzgjedhur në listë e ngushtë, rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë e deri te rekomandim i Komisionit Përzgjedhës për kandidatin e suksesshëm janë veprime të pavlefshme juridikisht dhe nuk mund të prodhojnë efekte juridike pasi që deri të ky rezultat ka ardhë si pasojë e një procedure të përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit material të përcaktuara si më lartë.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve ankimore të ankueses për shkelje të parimeve të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (ligj ky i aplikueshëm edhe sipas shpalljes publike të rekrutimit), vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe duke marr parasysh dispozitat të aplikuara ligjore në fuqi duke përfshirë konstatimet e shkeljeve të paraqitura si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura e rekrutimit sipas konkursit me 01/2023 për pozitën “Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve” në Gjykatën Komerciale të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë deri në fazën e përfundimit dhe njoftimit për kandidatin e suksesshëm për arsyet e dhëna si më lartë është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit po ashtu, nisur nga konstatimet e dhëna si më lartë ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.20/2023 të datës 23.06.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ngase nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe se i njëjti është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 11.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material” kështu që për shkak të paligjshmërisë i njëjti është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankues është aprovuara si e bazuar.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se për shkak të konstatimit të shkeljeve procedurale dhe materiale në fazën e përgatitjes se listës së ngushtë dhe me qëllim të eliminimit të tyre ka vendosur që lëndën ta kthejë në rishqyrtim në këtë fazë, ndërsa Komisioni Përzgjedhës i SKGJ-së obligohet të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të ri-zhvillojë procedurën e rekrutimit për pozitën “Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve” në Gjykatën Komerciale, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë dhe të bëjë rivlerësimin e të gjitha aplikacioneve të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit sipas kërkesave të dhëna në konkursin e datës 02.03.2023, duke u bazuar në konstatimet dhe pikëpamjet e dhëna juridike si në arsyetimin e këtij vendimi. Rrjedhimisht për shkak të konstatimit të këtyre shkeljeve qysh në fazën e hershme të përgatitjes se listës së shkurt, Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të palës ankueses e të cilat pretendime kanë të bëjnë me veprimet e mëvonshme, pas listës së ngushtë, ngase të njëjtat nuk do të kishin ndonjë efekt tjetër, pasi të gjeturat e theksuara si më lartë janë arsye e mjaftueshme që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e verifikimit dhe përpilimit të listës së shkurtë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1192/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.